

KONTRATE PER DHURIMIN E KUOTES

Sot, me 28/10/2019, lidhet kjo Kontrate per Dhurimin e Kuotes midis paleve te meposhtme:

- **Erjon Cenolli**, shtetas shqiptar, i datelindjes 05.11.1994, banues ne Tirane, mbajtes i dokumentit te identifikimit me nr. personal J41105047M;

ne cilesine e Ortakut te shoqerise **"FOREST & GARDEN TOOLS" SHPK**, nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar, e themeluar sipas ligjeve te Shqiperise, regjistruar ne Qendren Kombetare te Biznesit, me numer NUIS L92224033L dhe seli te ndodhur tek *"Rruga e Kavajes, Hyrja 6, Tirane, Shqiperi"*.

(në vijim referuar si **"Dhuruesi"**)

Dhe

- A. **Pellumb Cenolli**, shtetas shqiptar, i datelindjes 10.08.1962, banues ne Tirane, mbajtes i dokumentit te identifikimit G20810191U;

(ne vijim referuar si **"Perfituesi"**)

bashkërisht të referuar si **"Palët"**;

MEQENESE:

1. Dhuruesi eshte pronar i ligjshëm i kuotes që përfaqëson 40% të kapitalit themeltar të **"FOREST & GARDEN TOOLS" SHPK**, nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar, e themeluar sipas ligjeve te Shqiperise, regjistruar ne Qendren Kombetare te Biznesit, me numer NUIS L82218032S (ne vijim **"Shoqeria"**);
2. Dhuruesi i ofron Perfituesit 1 kuote e cila perfaqeson 40% te kapitalit themeltar te Shoqerise, (me poshte referuar si **"Kuota"**);
3. Perfituesi e pranon kete dhurim;

Palet lidhin kete Kontrate per Dhurimin e Kuotes (më poshte referuar si **"Kontrata"**), sipas termave dhe kushteve të mëposhtme:

Neni 1 Objekti i Kontrates

Sipas kushteve dhe detyrimeve të përcaktuara në këtë Kontrate, me ane te kesaj Kontrate Dhuruesi bie dakord për t'i dhuruar Perfituesit Kuoten bashke me të gjitha të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga Kuota.

Palet pranojne se si rezultat i ketij dhurimi, kapitali i Shoqerise do te kete strukturen e meposhtme:

1- **Pellumb Cenolli** – zoterues i 1 (nje) kuote e cila perfaqeson 60% te kapitalit themeltar te Shoqerise;

2- **Lorenc Laba** – zoterues e 1 (nje) kuote i cili perfaqeson 40% te kapitalit themeltar te Shoqerise;

Neni 2 Transferimi i Kuotes

Transferimi i Kuotes dhe regjistrimi i kësaj Kontrate në Qendrën Kombëtare të Biznesit do te kryhen ne perputhje me ligjet e aplikueshme.

Transferimi i Kuotes behet ndermjet ortakeve te Shoqerise, duke qene keshtu ne perputhje me Statutin e Shoqerise dhe rregullimet e tij per transferimin e kuotave.

Neni 3 Garancitë e Dhuruesit

Dhuruesi garanton se:

- 3.1 Kapitali themeltar i Shoqerise është 1,000 Lekë.
- 3.2 Dhuruesi eshte pronar i ligjshëm i Kuotes, e cila dhurohet e lire nga cdo pengese apo kufizim, kolateral apo barre të çdo lloji.
- 3.3 Kuota e dhuruar sipas kesaj Kontrate perfaqeson 40% te kapitalit themeltar te Shoqerise.

Neni 4 Garancitë e Perfituesit

Perfituesi garanton, deklaron dhe merr përsipër kundrejt Dhuruesit sa më poshtë:

Perfituesi merr përsipër të gjitha detyrimet e tashme dhe te ardhshme, pa asnje kufizim, në lidhje me Kuoten, si ortak i 60% të kapitalit themeltar të Shoqerise dhe nepermjet kesaj Kontrate heq dorë nga çdo e drejtë per t'i kunderdrejtuar ndonjë pretendim Dhuruesit në të ardhmen ne lidhje me detyrime te pashlyera ose pretendime te paleve te treta ne lidhje me Kuoten ose me pergjegjesine e tij si ortak i 60% të kapitalit themeltar të Shoqerise.

Neni 5 Pjesshmeria

Nëse ndonjë nga pjeset e kësaj Kontrate do të behet e pazbatueshme për çfarëdo arsye, pjesa e mbetur e kësaj Kontrate do të vazhdojë te jete në fuqi me efekt të plotë. Nëse ndonjë dispozitë e kësaj Kontrate është e pavlefshme ose e pazbatueshme nga cdo gjykate kompetente, dhe në qoftë se kufizimi i kesaj dispozite do ta bente te vlefshme, atëherë dispozita do te konsiderohet e formuluar sipas kufizimit.



Kjo Kontrate përbën te gjithë marrëveshjen midis Palëve dhe zëvendëson çdo marrëveshje paraprake ose garanci të çdo lloji para datës së kësaj Kontrate.

Kjo Kontrate mund të ndryshohet vetëm me shkrim dhe duhet të nënshkruhet nga të dy Dhuruesit dhe Perfituesi.

Neni 6 Ligji i zbatueshëm dhe juridiksioni


Kjo Kontrate do t'i nënshtrohet dhe interpretohet në përputhje me ligjet e Republikës së Shqipërisë.

Nëse lind një mosmarrëveshje, Palët do të përpiqen për të zgjidhur atë me diskutime dhe negociata para se të fillojnë procedurat ligjore. Gjykatat shqiptare do të kenë juridiksion ekskluziv mbi çdo mosmarrëveshje.

Neni 7 Te ndryshme

Kjo Kontrate nënshkruhet në 3 kopje në gjuhën Shqipe.

Per Dhuruesin:

Erjon Cenolli


Per Perfituesin:

Polluxh Cenolli
